

Tiranë, 18/12/2024

STATUTI
I
SHOQERISE “DoDrit” SHPK

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME
Neni 1

Ne ortaket themelues te shoqerise “DoDrit” SHPK me gjeneralitetet e cituara me poshte :

1-Olsjon Bylyku : i biri Hajriut, lindur ne Maminas me daten 18.04.1998 dhe banues ne Tirane ne adresen : Njesia Bashkiake nr.9, Rruga “Robert Naci”, Godine Private 29/1, mbajtes i leternjoftimit me nr. J80418046L.

2-Brikena Bylyku: e bija e Hajriut, lindur ne Tirane me daten 23.03.1992 dhe banues ne Tirane ne adresen:Rruga “Robert Naci” , Godine Private,mbajtes i leternjoftimit me nr.J25323080R.

deklarojme se aktiviteti i shoqerise “DoDrit” SHPK, do te organizohet dhe zhvillohet ne baze te ketij statuti dhe kerkesave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Neni 2

Shoqeria “DoDrit” SHPK është person juridik shqiptar dhe si i tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar, sipas ketij Statuti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit

Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është fiksuar për një periudhe kohe te pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëria ka si objekt te veprimtarisë se saj:

3.1 Prodhimi ,riprodhimi, shpërndarja e fonogrameve dhe e videove të shkurtëra muzikore të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës.

3.2 Qiradhënia e fonogrameve dhe e videove të shkurtëra muzikore të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës; huadhënia publike e fonogrameve dhe e videove të shkurtëra muzikore të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës.



3.3 Shfrytëzimi në mënyrë dixhitale në internet me anë të vënies në dispozicion të publikut nëpërmjet shpërndarjes në mënyrë dixhitale në platformat dixhitale përmes shitjes me anë të shkarkimeve dhe me anë të streaming të fonogrameve dhe të videove të shkurtëra muzikore të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës

3.4 Shfrytëzimi në mënyrë dixhitale në internet me anë të monetizimit në platformën “YouTube” si dhe në platformat e ngjashme me platformën “YouTube” të fonogrameve dhe të videove të shkurtëra muzikore të veprave muzikore të çdo lloji, duke përfshirë veprat muzikore në llojin e këngës, si pjesë përbërëse e veprave audiovizuale

3.5 Shitja e të drejtës së pronësisë së masterave përfundimtarë të fonogrameve dhe të kopjeve të para standarde të videove të shkurtëra muzikore të veprave muzikore të çdo lloji

3.6 Blerja dhe shitja nëpërmjet kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të të drejtave pasurore të kompozimeve muzikore me ose pa tekst, të të drejtave pasurore të krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore si dhe çdo krijim tjetër me gojë ose me shkrim, të lajmeve si dhe të informacioneve të shtypit që kanë karakter të thjeshtë informimi.

3.7 Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjetër të lejueshëm nga legjislacioni në fuqi.

Neni 5

Për përbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në ndërmarrje apo shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjte ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshëm e të paluajtshëm.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në leke apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë dhe Zyrat Qendrore të saj janë në adresën: Njesia bashkiake nr.9, rruga “Robert Naci”, Godinë Private 29/1, Tirane. Asambleja ka kompetencën të hapë filiale e agjensi të tjera dhe t’i mbyllë ato, nëse e quan të nevojshme.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet vetëm nga kontribute në para dhe është 10000 (dhjetemijë) Leke. Ai është i ndarë në 2 (dy) kuota të cilat zotërohen nga ortakët themelues si më poshtë :



1. **Olsjon Bylvku** zoteron 1(nje) kuote te bazavlefshme me 70 **(shtatedhjetë)%** te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **Brikena Bylvku** zoteron 1(nje) kuote te bazavlefshme me 30 **(tridhjetë)%** te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortakët me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat në fuqi të karakterit fiskal, kanë të drejtë të kryejnë pagesa apo të japin kontribute, në kapital, ose financime në favor të shoqerisë, të cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financuar, afati i kthimit dhe menyra e rimbursimit të tyre rregullohen me kontratën perkatese. Shumat e mesiperme mund të perdoren për të mbuluar humbjet ose transferohen direkt në rritjen e kapitalit në përputhje me vendimin e asamblese së ortakëve.

KREU III **TRANSFERIMI I PJESËVE NOMINATIVE TË KAPITALIT THEMELTAR** **Neni 8**

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme, ndërmjet ortakëve (me kontratë shitblerje ose dhurimi), ndërmjet bashkëshorteve (në rastin e ndarjes së pasurisë në bashkëpronësi familjare) dhe tek trashëgimtarët (në rast vdekje), dhe kalimi i tyre bëhet pa miratimin e asamblese, (të ortakëve të tjerë).

Transferimi i pjesëve nominativë të kapitalit themeltar tek të tretët (persona fizike ose juridike jashtë bashkësisë së ortakëve) bëhet duke ezauruar fillimisht, të drejtën e parablerjes së ortakëve të tjerë, në përputhje me procedurën që vijon:

Ortaku që kërkon të transferojë kuotën e tij, tek të tretët, tërësisht apo pjesërisht, është i detyruar që fillimisht t'i rezervojë ortakëve të tjerë të drejtën e parablerjes. Për të mundësuar ushtrimin e kësaj të drejte, ortaku që dëshiron të transferojë kuotën e tij (ose një pjesë të saj) duhet të lajmërojë me shkrim (me letër-rekomandë) të gjithë ortakët që figurojnë në Statut (në adresën që rezulton në statut për secilin ortak), duke specifikuar çmimin e shitjes, mënyrën e pagesës dhe emrat e blerësve të mundshëm.

Çdo ortak i interesuar për blerjen e kuotes, duhet të përgjigjet ortakut ofertues, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, me të cilin deklaron se dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes për teresinë e të gjitha kuotave të ofruara (ose për një pjesë të tyre). Njoftimi duhet t'i dërgohet ortakut ofertues brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ofertes, në të kundërt konsiderohet se është hequr dorë nga e drejta e parablerjes, dhe ortaku ofertues është i lire të transferojë kuotën tek të tretët, por jo me çmim më të ulët dhe me kushte më të favorshme se çmimi dhe kushtet që i ka ofruar ortakëve, në të kundërt shitja e kuotes tek të tretët konsiderohet e pavlefshme.

Nëse e drejta e parablerjes ushtrohet nga më shumë se një ortak, pjesëmarrja në oferte e secilit ortak do të jetë në përpjestim me kuotat që zoteron secili prej tyre.

Nëse një ortak që gëzon të drejtën e parablerjes nuk mundet ose nuk dëshiron t'a ushtrojë atë, e drejta e ortakut që refuzon apo terhiqet, (e drejta e parablerjes për këtë pjesë) i kalon ortakëve të tjerë në proporcion me kuotat që zoteron secili.

E drejta e parablerjes ushtrohet për çmimin e ofruar nga ofruesi.




Perjashtohet e drejta e parablerjes per rastet e pengut, por ortakët kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e ekzekutimit të detyrueshem apo të shitjes së kuotave të lena peng.

KREU IV
ASAMBLEJA
Neni 9

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimor i shoqërisë, që përfaqëson tërësinë e ortakëve.

Vendimet e saj merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me këtë Statut dhe janë të detyrueshme për të gjithë ortakët. Ato protokollohen në regjistër të veçantë në përputhje me ligjin.

Asambleja ka të drejtë të ushtrojë në çdo moment verifikime mbi Administratorin/et dhe të kontrollojë çdo dokument të shoqërisë. Ajo mund të urdhërojë apo të udhëzojë administratorin/et në kryerjen e detyrës së tij.

Asambleja ka këto kompetenca:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
- Vendos për ndryshimet e statutit;
- Emeron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/et, miraton buxhetin vjetor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- Vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Vendos për pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Vendos për riorganizimin (shendrrimin, bashkimin me shoqëri të tjera, ndarjen), dhe/ose prishjen e shoqërisë;
- Vendos për transferimin (blerjen, shitjen dhurimin, shkëmbimin) e pasurive të shoqërisë, për cedimin apo për dhenien me qira të shoqërisë ose degeve të saj, për dhenien me qira të aseteve të shoqërisë, për marrjen me qira të objekteve apo aseteve të ndryshme, për kontratat leasing, për pjesëmarrjen në kapitalin e kompanive të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital, blerjes së kuotave apo aksioneve;
- Vendos për miratimin e huamarrjeve me interes nga të tretet, si dhe për huamarrjet pa interes për vlera më 20.000 Euro (njetetë mijë);
- Vendos për dhenien e garancive hipotekore, pengut, barreve siguruese, dorezanise etj;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel të miratuar;
- Miraton shpërdarjen e fitimit, nëpërmjet ndarjes së dividendëve ose vendos për kapitalizimin e tyre nëpërmjet zmadhimit të kapitalit;
- Miraton strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme dhe organogramen, rregulloren e sigurimit teknik, si dhe politikën dhe nivelin e pagave dhe shpërblimeve për çdo vend pune në shoqëri;
- Vendos për çështje të tjera të parashikuara nga ligji;



Neni 10 **Vendimarrja**

Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te zakonshme, jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 30 për qind të kapitalit te shoqerise (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Per Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortakët (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me **75%** (shtatedhjeteepesepërqind) te votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me siper, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shndërrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë,
- Shperndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;
- Percaktimi i politikës dhe masës së pagave dhe shperblimeve per cdo pozicion pune ne shoqeri, duke pershire edhe percaktimin e pages apo shperblimin e Administratorit, ekspertit kontabel te miratuar dhe likujduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakeve qe përfaqësojnë te paktën 5% te kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Nëse Asambleja e Përgjithshme, refuzon kërkesën e ortakeve qe përfaqësojnë te paktën 5% te kapitalit themeltar, per nisjen e një hetimi te posaçëm ose nuk jep përgjigje brenda 60 ditëve atëherë, kërkuessit kane te drejte t'i drejtohen gjykatës.

Neni 11 **Zmadhimi i kapitalit themeltar**

Vendoset nga Asambleja me **75%** (shtatedhjeteepesepërqind) te votave te ortakeve pjesemarres. Pas vendimit te asamblesë për zmadhimin e kapitalit, ortakët brenda 30 ditëve duhet te bëjnë derdhjet respektive, ne proporcion me kuotën e kapitalit qe zotëron secili.

Ortakët qe kane votuar kundra zmadhimit te kapitalit nuk janë te detyruar te kontribuojnë.

Depozitimi i kapitalit te zmadhuar, behet vetëm nga ortakët qe kane votuar pro rritjes se kapitalit, secili sipas kuotës qe është vendosur ne asamble. Ne mungese marrëveshje për rindarjen e kuotave, barazohet me 100 (njëqind) shuma e kapitalit pas zmadhimit. Pas derdhjes se kontributeve te sipërpërmendura, Administratori/et duhet te regjistrojne ne librin e ortakeve zmadhimin e kapitalit,



duke marre nënshkrimin e atyre që kanë pranuar; si dhe të vazhdojnë me një përshkrim të ndarjes së kapitalit midis ortakëve.

Administratori/et me ligj dhe pa autorizim paraprak të Asamblesë, mund t'u kërkojnë llogari ortakëve që kanë nënshkruar zmadhimin e kapitalit, për derdhjen e kontributeve brenda afatit të sipërpërmendur.

Neni 12 **Zvogëlimi i kapitalit**

Vendoset nga Asambleja me 75% (shtatëdhjetepesepërqind) të votave të ortakëve pjesëmarrës.

Kur vendimi i zvogëlimit të kapitalit nuk motivohet nga humbjet në aktive, kreditorët e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë; ata mund të kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

Neni 13 **Transformimi**

Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri anonime, bëhet mbas hartimit të raportit përkatës nga Administratori dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme me një shumicë prej tre të katërtave, në përputhje me nenet 228 dhe 229 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë në kundërshtim me këtë dispozitë.

ADMINISTRIMI **Neni 14**

Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohen një Administratori të Vetëm, që mund të jetë edhe ortak në shoqëri. Administratori i vetëm emërohet për një periudhë prej 5 vjetesh me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim dorëheqje apo shkarkimi nga ana e Asamblesë.

Në detyrën e Administratorit emërohet: **Z.Brikena Bylyku** e bija e Hajriut, banues në adresën: rruga "Robert Naci", mbajtes i letërnjoftimit me nr.J25323080R.

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektivit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Në përmbushje të detyrës së tij, ai ka të drejtë dhe detyrim të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; të përfaqësojë shoqërinë tregtare; të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; të përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,

Administratori kryen edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut si edhe mund të vere në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokurë në rastë gjyqësor, duke kryer operacione bankare, këtu përfshirë edhe hapjen e llogarive rrjedhëse,



nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke në dore apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Viti ekonomik fillon me 01 Janar deri me 31 Dhjetor çdo viti.

Neni 15

Administratori mund të emërojë përfaqësues, të cilëve, individualisht apo kolektivisht, mund t'u japë të drejtën e firmës, si dhe ato kompetenca, shpërblime e garanci që do të vlerësojë të arsyeshme. Ai mundet gjithashtu të emërojë drejtues ose përfaqësues për akte apo kategori aktesh të caktuar.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori (apo administratore të nëse do të emërohen të tilla) janë përgjegjëse individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj të tretëve, për aktivitete të kryera nga administratori në kundërshtim me kompetencat e tij, kur vërtetohet se ata ishin në dijeni të kësaj rrethane.

Administratori përgjigjet personalisht para shoqërisë dhe/ose të tretëve që kanë pësuar dëme nga ndonjë veprim i tij i paligjshëm.

Neni 17

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhënë një motivacion. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratoreve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administratori/ret mund të heq/in dorë në çdo kohë nga detyra e tij/tyre, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori/ret, që jep dorëheqjen, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

PERFAQESIMI I PUNEMARRRESVE

Neni 18

Nëse shoqëria ka më shumë se 50 punonjës atëherë ata kanë të drejtën të organizojnë një Këshill të Punëmarrësve me një mandat 5-vjeçar me të drejtë ripërtëritje ose kur shoqëria ka të punësuar më shumë se 20 punëmarrës po më pak se 50 atëherë për çdo 10 punëmarrës zgjidhet një përfaqësues. Këshilli i Punëmarrësve apo përfaqësuesit e tyre gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara nga neni 20 i Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".



EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Neni 19

Emërimi i ekspertit kontabël të autorizuar bëhet me vendim të asamblesë së përgjithshme e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e ekspertit kontabël të autorizuar, janë të pavlefshme operacionet e kryera pa prezencën e tij.

Neni 20

Eksperti Kontabël i autorizuar pasi ka verifikuar librat kontabël, arkën dhe depozitat bankare, garanton që kontabiliteti vjetor është mbajtur në rregull, i korrespondon të vërtetës dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mund të shkarkohet nga funksionet e tij me vendim të asamblesë së përgjithshme si dhe me vendim gjykatë.

Eksperti Kontabël i autorizuar përpilon dhe i paraqet Asamblesë një raport financiar mbi ushtrimin vjetor që pasqyron situatën financiare në nisje dhe atë në mbyllje.

Kontrollon që bilanci përfundimtar dhe Raporti i përpiluar nga Administratori për Asamblenë, t'i korrespondojë realitetit.

Është i detyruar të paraqesë Administratorit dhe asamblesë së ortakeve:

- a) Kontrollin, verifikimin dhe sondazhet e bëra ;
 - b) Zërat e bilancit dhe dokumentacionin kontabël që duhet korrigjuar duke sygjerruar edhe zgjidhjet;
 - c) Gabimet dhe pasaktësitë e konstatuara ;
 - d) Rezultatit financiar pas korrigjimeve të bëra;
- Ai duhet të thirret në të gjitha mbledhjet e asamblesë së ortakeve ku aprovohet bilanci i aktivitetit gjithë vjetor, por mund të thirret në të gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme.

Neni 21

Eksperti kontabël i autorizuar përgjigjet ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e negative që rrjedhin nga gabime e neglizhime në kryerjen e funksionit të tij.

Nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore të kryera nga administratori, me përjashtim të rasteve kur ka pasur dijeni për to, por nuk ia ka paraqitur dhe raportuar asamblesë.

KREU IV **FITIMIT DHE FONDET**

Neni 22

Fitimi që do të shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjatë vitit financiar të sapo mbyllur.

Asambleja mund të vendosë për formimin dhe shpërndarjen e fondeve të ndryshme.

Neni 23



Asambleja vetem pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën që do të shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për ortakun e vetem.

Shoqëria mund t'i shpërndajë fitime ortakut të vetem, vetëm nëse administratori apo administratori, nën përgjegjësinë të tyre personale, lëshojnë një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nën 77 të Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"

Gjate vitit, shoqëria ka të drejtë t'i japë ortakut të vetem paradhënie mbi dividendët në vlera jo më të mëdha se dividendi i shpërndarë në vit me parë, me kusht që:

- a) Të mbetet e depozituar një rezervë, e barabartë me paradhëniet që do të shpërndahen;
- b) Një Eksperti kontabël i autorizuar të vërtetojë në një relacion me shkrim që fitimet neto të realizuara deri në atë moment janë më të mëdha se paradhëniet që parashikohen për të shpërndarë ortakëve.

Shpërndarja e paradhënieve vendoset nga asambleja ose administratori. Në vendimin përkatës duhet të specifikohen shumat dhe datat e kthimit.

Dividendët që nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakëve që i kanë marrë ato.

KREU V
PAVLEFSHMERIA E SHOQËRISË, PRISHJA, LIKUJDIMI DHE LARGIMI I
ORTAKEVE
Neni 24

Pavlefshmeria absolute apo relative e themelimit të shoqërisë, mund të konstatohen apo të shpallen vetëm nëse plotësohen një apo disa nga kushtet e parashikuara në nenin 3/1 të Ligjit Nr. 129/2014. Edhe pasojat e pavlefshmerisë, do të zgjidhen në përputhje me kërkesat e dispozitës së cituar më sipër.

Neni 25

Shoqëria mund të prishet vetëm në këto raste:

- a) për çdo shkak të vendosur nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaft-tueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- d) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- dh) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara ligj;
- e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;

Neni 26
LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të



Neni 27
LIKUJDIMI

Kur me vendim gjykatë shpallet pavlefshmëria absolute apo relative e shoqërisë si dhe në rastet e parashikuara në statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme të shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit që do të kryhen sipas kërkesave të parashikuara në Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

ORTAKET E SHOQËRISË "DoDrit" SHPK

Brikena Bylyku



Olson Bylyku

